

GL48 mg/dL MATËS I GLICEMISË (kodi i artikullit 463.66)




- I LEHTË DHE I THJESHTË NË PËRDORIM
- EKRAN I MADH
- SHIRIT I NDRITSHËM NË FOLENË E FUTJES
- DY PILA BUTON CR2032 TË VENDOSURA PARAPRAKISHT
- ME STIOLAPS SHPUES GISHTI
- ME KABËLL PËR TRANSFERIMIN E TË DHËNAVE
- PA KODIFIKIM (PA KALIBRIM)
- SASIA E GJAKUT TË KËRKUAR: 0,5 µl
- KOHËZGJATJA E MATJES: rreth 5 SEKONDA
- 900 VLERA TË MEMORIZUARA (ME DATË dhe ORË)
- PËRLLOGARITJE E MESATARES: 7, 14, 30 dhe 90 DITË
- MARKIM I REZULTATEVE
- GAMA E MATJEVE: 20 – 630 mg/dL
- FIKJE AUTOMATIKE

50 SHIRITA REAKTIVË PËR GL48/GL49 (kodi i artikullit 463.76)







- PAKETË SHIRITASH REAKTIVË (2 kuti me nga 25 shirita)
- SHIRIT I MADH REAKTIV ME SHIGJETË PËR TË LEHTËSUAR FUTJEN
- KOHËZGJATJA E PAKETËS SË HAPUR 24 MUAJ
- SHIRITI MUND TË PREKET KUDO (ME DUAR TË PASTRA) PA U DËMTUAR BUTONI PËR NXJERRJEN E SHIRITIT
- BUTONI PËR NXJERRJEN E SHIRITIT

BEURER GL48 MATËS GLICEMIE DHE SHIRITA REAKTIVË PËRDORIMI I PRODUKTIT

	<p>VËNIA NË PUNË Bateritë janë futur paraprakisht në instrument. Hiqni mbrojtësen izoluese duke e tërhequr.</p>
	<p>CILËSIMET BAZË Ndizni instrumentin me butonin on/off (ndezur/fikur) (6) dhe shtypni butonin SET (konfiguro) (8). Treguesi i vitit pulson, konfiguroni vitin me butonat anësore me ngjyrë të gjelbër "+" dhe "-" (9) dhe konfirmojeni me butonin SET (8). Veproni njësoj për të konfiguruar: Dita - Muaji - Ora - Minutat.</p>
	<p>Vijoni për të konfiguruar kufirin e poshtëm të vlerave normale të glicemisë (vlera e propozuar 80), kufirin e sipërm të vlerave normale të glicemisë (vlera e propozuar 180) dhe me aktivizimin/çaktivizimin e sinjalit akustik (BIP).</p>
	<p>PËRGATITJA E INSTRUMENTIT Futeni shiritin reaktiv në aparat, me kontaktet e përparme siç tregohet nga shigjeta. Instrumenti ndizet.</p>
	<p>Pas rreth 3 sekondash do të shfaqet në ekran simboli i një pike gjaku që pulson: instrumenti është gati për matjen.</p>
	<p>MARRJA E KAMPIONIT TË GJAKUT Pasi të keni ndryshuar gjilpërën shpuese të gishtit, afrojeni në anë të majës së gishtit dhe shtypni butonin lëshues. Pika e gjakut duhet të ketë dimensionin minimal prej 1,2 mm (• dimension i saktë i pikës) Gjaku nuk duhet të përhapet në gisht</p>

	<p>Vendoseni shiritin e pikës së gjakut, siç tregohet në imazh, pa e hequr shiritin nga instrumenti.</p> <p>Shiriti e thith automatikisht gjakun e nevojshëm për realizimin e testit dhe instrumenti lëshon një BIP.</p>						
	<p>Kujdes! Shiriti mund ta thithë gjakun vetëm nga e çara në majë. Nëse gjaku vihet sipër ose poshtë shiritit, testi nuk realizohet saktë.</p>						
	<p>LEXIMI I REZULTATIT</p> <p>Numërimi mbrapsht prej 5 sekondash fillon automatikisht.</p> <p>Rezultati shfaqet në ekran me datën, orën dhe një vizë të pozicionuar në raport me ngjyrën e kuqe, të gjelbër dhe të verdhë.</p> <p>Viza ndihmon në interpretimin e rezultatit: Viza sipër të kuqes = glicemi e ulët Viza sipër të gjelbrës = glicemi normale Viza sipër të verdhës = glicemi e lartë</p>						
 <table border="1" data-bbox="217 1558 630 1669"> <tr> <td></td> <td>Prima del pasto.</td> </tr> <tr> <td></td> <td>Dopo il pasto.</td> </tr> <tr> <td></td> <td>Marcatura generale (ad es. dopo sforzo fisico).</td> </tr> </table>		Prima del pasto.		Dopo il pasto.		Marcatura generale (ad es. dopo sforzo fisico).	<p>Markimi i rezultatit (fakultativ)</p> <p>Është e mundur ta markoni rezultatin përmes "butonit të mollës": shtypeni një herë për "para ngrënies"; 3 herë për markimin e përgjithshëm; 4 herë për anulimin e markimit. Markimi nuk është i detyrueshëm.</p>
	Prima del pasto.						
	Dopo il pasto.						
	Marcatura generale (ad es. dopo sforzo fisico).						

	<p>HEQJA E SHIRITIT Përdorni butonin anësor për të hequr shiritin, pa e prekur këtë të fundit. Instrumenti fiket automatikisht.</p>
	<p>MEMORIA E VLERAVE Matjet ruhen automatikisht me datë dhe orë (maks. 900 matje). Për të shfaqur memorien: ndizni instrumentin me butonin on/off dhe shtypni butonat e gjelbër anësorë “+” ose “-“. Simboli i ditarit shfaqet midis orës dhe datës.</p>
	<p>MESATARJA E VLERAVE Është e mundur të shfaqni vlerën mesatare të glicemisë të 7, 14, 30 dhe 90 ditëve të fundit. Ndizeni instrumentin me butonin on/off dhe shtypni dy herë butonin “+”. Me shtypjen e butonave të gjelbër “+” dhe “-“, mund të shfaqni vlerat mesatare me dhe pa markim.</p>
	<p>TRANSFERIMI I VLERAVE NË KOMPJUTER DHE APLIKACION Lidhni glukometrin me kompjuterin me kabllin e marrë në dorëzim. Është e mundur të transferohen të dhënat në softuerin Glucomemory, HealthManager dhe përmes HealthManagerPro Uploader në aplikacionin në smartfon. GL48 i transferon në Smart Digital Clinic dhe Glooko.</p>

Dokumenti i disponueshëm në 

Kliko këtu për videon udhëzuese- link WWW.beurer-medical.it

**SHËRBIMI I KLIENTIT BEUER MEDICAL ITALIA
PËR SUPORT TEKNIK**

Numri i gjelbër i Shërbimit të Klientit



- Funkcional 7 ditë në 7, çdo ditë të vitit
- Nga ora 8:00 deri në orën 13:00 dhe nga ora 14:00 deri në orën 18:00



www.beurer-medical.it



service-it@beurer-medical.de

RREGULLAT PËR ASGJËSIMIN E DUHUR TË MATERIALEVE TË HEDHURA

Pas përdorimit, hidhni shiritat reaktivë dhe gjilpërat në një kontenitor rezistent.

Për hedhjen e shiritave reaktivë dhe të gjilpërave shpuese të gishtit, respektoni në mënyrë rigorozë masat parandaluese të vlefshme përgjithësisht për trajtimin e gjakut. Hidhni me kujdes gjithë kampionet e gjakut dhe materialet me të cilat keni rënë në kontakt ju ose asistentët tuaj, me qëllim parandalimin e lëndimeve dhe infektimin e personave të tjerë. Të gjithë komponentët e matësit dhe të aksesorëve mund të bien në kontakt me gjakun njerëzor dhe përfaqësojnë një burim të mundshëm infektimi. Hidhni bateritë e konsumuara dhe plotësisht të shkarkuara pranë pikave përkatëse të grumbullimit, pikave të grumbullimit të mbetjeve ose dyqaneve të pajisjeve elektronike. Hedhja e baterive është një detyrim ligjor.

Mbi bateritë që përmbajnë substanca toksike, janë vendosur simbolet e mëposhtëm:



Pb = bateria përmban plumb,
Cd = bateria përmban kadmium,
Hg = bateria përmban mërkur.

Për mbrojtjen e ambientit, në përfundim të ciklit jetësor, aparati dhe kabli i lidhjes nuk duhet të hidhen në mbeturinat shtëpiake, por duhet të dërgohen në qendrat e posaçme të grumbullimit. Hidheni aparatin në përputhje me direktivën evropiane lidhur me mbetjet e aparaturave elektrike dhe elektronike (RAEE). Në rast dyshimesh, drejtojeni autoriteteve komunale kompetente për asgjësimin.

Ambalazhi prej stofi mund të hidhet bashkë me mbetjet e zakonshme ose sipas udhëzimeve të komunës përkatëse të banimit

